



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M Nr.13,

datë 4.05.2017

Për

*“Shqyrtimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit Altelecom Sh.a. për  
Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me Nr.2703 dhe 2704, datë 22.12.2016”*

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Zj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Zj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Zj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 4.05.2017, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

▪ **Shqyrtim i ankimit administrativ të sipërmarrësit Altelecom Sh.a., depozituar në AKEP me shkresë Nr. 422 Prot, datë 20.02.2017 (Nr. 371 Prot., AKEP datë 23.1.2017) me objekt:**

- Ndryshimin e Vendimit nr.2703, datë 22.12.2016, të Këshillit Drejtues të AKEP për “*Miratimin e Dokumentit: Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse - Dokumenti Perfundimtar*” për ndryshimin e përmbajtjes së dokumentit për Rregullimin e tarifave në lidhje me nivelin e tarifave për shërbimet e LLU-së dhe *bitstream* si dhe derregullimin e tarifave të linjave me qira;
- Ndryshimin e Vendimit nr.2704, datë 22.12.2016, të Këshillit Drejtues të AKEP për “*Rregullimin e tarifave të sipërmarrësit Altelecom Sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg për tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe linjat me qira*”, për ndryshimin e pikës 1.a, tabela 1, pikës 2.a, Tabela 3, pikës 2.b) të Vendimit në lidhje me nivelin e tarifave të LLU-së dhe *bitstream* si dhe shfuqizimin e pikës 3 të Vendimit për derregullimin e tarifave të linjave me qira.

## BAZA LIGJORE:

1. Shkronja II) e nenit 8, nenet 36, 44, 53,55 e vijues të ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
2. Neni 130 e vijues të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (**ligji nr. 44/2015**);
3. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP .

## K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa e Albtelecom sh.a me Nr. 422, datë 20.01.2017, (referencë AKEP nr.prot 371, datë 23.01.2017);
2. Shkresa e Albtelecom sh.a me Nr.422/2 Prot., datë 28.02.2017 (Referenca e AKEP: Nr.371/2 Prot., datë 2.03.2017) - Ankim administrativ;
3. Shkresa e Vodafone Albania sh.a me ref. LEA/036/0X, datë 18.04.2017 (referenca e AKEP: Nr.371/5 prot., Datë 19.04.2017);
4. Shkresa e Abissnet sh.a me Nr.2345 Prot., Datë 18.04.2017 (referenca e AKEP: Nr.1186 prot., Datë 26.04.2017);
5. Shkresa e Nisatel sh.a. me Nr.prot.356, datë 21.04.2017 (referenca e AKEP: nr.1176 prot., datë 25.04.2017);
6. Shkresa e Tele.Co Albania sh.p.k me Nr.prot.65, datë 26.04.2017 (referenca e AKEP: nr.1205 prot., datë 27.04.2017);
7. Shkresa e Sintel sh.p.k me Nr.prot.35, datë 26.04.2017 (referenca e AKEP: nr.1216 prot., datë 28.04.2017);
8. Shkresa e Abcom sh.p.k me Nr.prot.215, datë 2.05..2017 (referenca e AKEP: nr.1224 prot., datë 2.05.2017);
9. Shkresa e Vivo Communication me Nr.prot.655, datë 28.04.2017 (referenca e AKEP: nr.1228 prot., datë 3.05.2017);
10. Raporti mbi përfundimin e këshillimit publik të dokumentit “*Rishikimi i tarifave të aksesit bitstream dhe LLU të miratuara me Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2703 dhe 2704, datë 22.12.2016*” (**Raporti**);
11. Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**);
12. Projekt-Aktin vendimmarrës të Këshillit Drejtues në përfundim të shqyrtimit të Ankimit, të rekomanduar nga struktura e ngarkuar për trajtimin e çështjes (**Projekt Vendimi**).

si dhe duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

## V Ë R E N:

1. Albtelecom me shkresën me Nr. 422, datë 20.01.2017, (referencë AKEP nr. prot 371, datë 23.01.2017), ka ankimuar në rrugë administrative vendimet nr.2703 dhe 2704, datë 22.12.2016.
  - Kërkesat dhe argumentat kryesore të Albtelecom të parashtruara në ankimin administrativ për ndryshimin e vendimeve të cituara janë si më poshtë:
  - VKD nr.2704 për “*Rregullimin e tarifave të sipërmarrësit Albtelecom Sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg për tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe linjat me qira*”, duke kërkuar nga AKEP ndryshimin e pikës 1.a, pikës 2.a, Tabelës 3, pikës 2.b të Vendimit në lidhje me nivelin e tarifave të LLU dhe Bitstream si dhe shfuqizimin e pikës 3 të Vendimit për derregullimin e tarifave të linjavë me qera;
  - VKD nr.2703 për “*Miratimin e Dokumentit: Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse - Dokumenti Perfundimtar*” duke kërkuar nga AKEP ndryshimin e përmbajtjes së dokumentit për rregullimin e tarifave me nivelin e tarifave për shërbimet LLU dhe Bitstream si dhe derregullimin e tarifave të linjavë me qera.
2. Këshilli Drejtues i AKEP në mbledhjen e datës 16.02.2017, sipas rendit të ditës mori në shqyrtim ankimin administrative të sipërmarrësit Albtelecom Sh.a, dhe në mbështetje të nenit 136 të ligjit nr. 44/2015, Këshilli Drejtues, vlerësoi se:
  - Ankimi është i pranueshëm dhe se duhet ti japë mundësinë Ankimuesit që të paraqesë prova, dokumente, vlerësime apo komente me qëllim në arritjen e rezultateve përfundimtare për marrjen e vendimit përfundimtar nga AKEP, lidhur me ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e aktit administrativ të ankimuar.
  - Të pranojë shqyrtimin e ankimit administrativ të paraqitur nga sipërmarrësi Albtelecom Sh.a., depozituar në AKEP me shkresë Nr. 422 Prot, datë 20.02.2017 (Nr. 371 Prot., AKEP datë 23.1.2017).
  - Të kryhen hetime administrative shtesë nga struktura e ngarkuar në AKEP për trajtimin e çështjes duke i kërkuar ankimuesit që brenda datës 28.02.2017 të depozitojnë në AKEP nëse kanë dokumenta, prova ose argumenta të tjera përveç atyre të depozituara në ankim.
  - Në përfundim të procedurës sipas nenit 136 të ligjit nr.44/2015 dhe përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 9918, lidhur me trajtimin e thelbit të çështjes dhe procesin e këshillimit publik, struktura e ngarkuar për trajtimin e çështjes të paraqesi brenda afatit ligjor, në mbledhjen e Këshillit Drejtues, praktikën dokumentare për shqyrtim lidhur me ankimin.
3. AKEP me shkresën nr.371/1 Prot., datë 20.02.2017 njoftoi Albtelecom për vlerësimin e ankimit të dërguar prej tij dhe Albtelecom me shkresën Nr.422/2 Prot., datë 28.02.2017 (Referenca e AKEP: Nr.371/2 Prot., datë 2.03.2017), ka dërguar argumenta shtesë për ankimin për tarifën e LLU dhe aksesit bitstream.
4. AKEP me Vendimin nr.9, datë 16.03.2017 për miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit “*Rishikimi i tarifave të aksesit bitstream dhe LLU të miratuara me Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2703 dhe 2704, datë 22.12.2016*”. Dokumenti kishte si objekt vetëm rishikimin e tarifave të LLU dhe aksesit bitstream, ndërsa tarifën e tjera të miratuara me Vendimet 2703 dhe 2704, datë 22.12.2016, u konsideruan si finale dhe të aplikueshme sipas përcaktimeve të akteve të cituara.

5. Dokumenti “*Rishikimi i tarifave te aksesit bitstream dhe LLU të miratuara me Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2703 dhe 2704, datë 22.12.2016*” u publikua në faqen e Internetit të AKEP dhe këshillimi publik u krye në periudhën 17.03.2017-17.04.2017. Në përfundim të procesit të këshillimit në AKEP kanë depozituar komente mbi dokumentin:
- Vodafone Albania sh.a me shkresën ref. LEA/036/OX, datë 18.04.2017 (referenca e AKEP: Nr.371/5 prot., Datë 19.04.2017);
  - Abissnet sh.a me shkresën Nr.2345 Prot., Datë 18.04.2017 (referenca e AKEP: Nr.1186 prot., Datë 26.04.2017).<sup>1</sup>
6. Në vijim të shqyrtimit të komenteve të palëve të interesuara, struktura përgjegjëse e AKEP ka përgatitur për Këshillin Drejtues dokumentin “Raporti mbi përfundimin e këshillimit publik për dokumentin “*Rishikimi i tarifave te aksesit bitstream dhe LLU të miratuara me Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2703 dhe 2704, datë 22.12.2016*””, i cili përmban ndër të tjera komentet kryesore të depozituara për dokumentin e nxjerrë në këshillim publik dhe trajtimin e tyre si më poshtë:
- Sipërmarrësi Vodafone Albania shprehet se AKEP ne parim duhet perzgjedhe si metode primare te zbatoje orientimin e tarifave ne kosto dhe se cdo metodologji tjeter, qofte ajo benchmark apo retail minus, nuk duhet te jete zgjedhja e pare e tij por zbatimi i Rekomandimit te KE te 11 Shtator 2013. Ne kushtet kur nuk zbatohet metodologjia e orientimit ne kosto Vodafone gjykon se reduktimi i tarifave ne masen e konkluduar me heret (rreth 18%) eshte i nevojshem dhe i arsyeshem per te arritur synimin e rritjes se konkurrences ne treg nepermjet uljes se kostove per operatoret e tjere dhe rrjedhimisht ofrimin e nje sherbimi me te aksesueshem per konsumatorin. Per sa i takon argumentave te Albtelecom per rishikimin e tarifave te aksesit bitstream dhe LLU, Vodafone komenton se pavaresisht investimit te inkumbentit ne NGN ai eshte percaktuar si operator FNT dhe ne kete treg nuk ekziston konkurrence efektive, cka do te thote se AKEP duhet te jete me vigjilent dhe te marre masat e nevojshme ex-ante per te siguruar nje konkurrence efektive si dhe AKEP duhet te vijoje te monitoroje me kujdes dhe ne vazhdimesi tregun, pasi pjeset e tregut te operatorit inkumbent (ne nivelin e pakices dhe ne nivelin e shumices), infrastruktura e tij e padublueshme, shtrirja kombetare e rrjetit fiber dhe integrimi vertikal i garantojne ketij lojtari nje avantazh te dukshem ne tregjet e pakices, e per rrjedhoje krijon kushte/premisa per zbatimin e mundshem te praktikave antikonkurrese 'margin squeeze'.
  - Sipërmarrësi Abissnet sh.a<sup>2</sup> komenton se i niveli i ri i tarifave te propozuara me reduktim me 2.1% nga niveli i Tetor 2016 nuk eshte i arsyeshem, për shkak se

---

<sup>1</sup> Në vijim të ankimeve të disa operatorëve të tjerë alternativë (të cituara në këtë dokument) për ofertat promovionale të Albtelecom në Prill 2017 për “i+fix”, pavarësisht se ato nuk janë depozituar direkt si komente për këshillimin publik, AKEP i ka bërë ato pjesë të procesit për shkak të lidhjes së objektit të ankimeve me objektin e këtij vendimi.

<sup>2</sup> Sipërmarrësi Nisatel sh.a me shkresën nr.1176 prot., datë 25.04.2014 (referenca e AKEP) ka paraqitur një kërkesë ankimore (jo si komente për këshillimin publik) në lidhje me ofertat promovionale të Albtelecom në Prill 2017 për paketat “i+fix” ku përmban argumenta të ngjashëm me Abissnet për marzhin midis cmimeve me shumicë të propozuara të aksesit bitstream dhe cmimeve me pakicë të ofertave promovionale të Albtelecom. Njëkohësisht operatorët Tele.co. Albania, Sintel dhe Vivo Communication kanë dërguar në AKEP shkresa identike me Nisatel. Të katër këta operatorë kërkojnë ndër të tjera dhe ndalimin e skontove të cituara nga Albtelecom dhe vendosjen e një cmimi dysheme me pakicë për aksesin broadband nga rrjete fikse në nivelin 1500 lek/muaj.

nuk krijon marzh të arsyeshëm midis cmimeve me shumicë të aksesit bitstream dhe cmimeve me pakicë të Albtelecom për paketat “i+fiks” të hedhura në treg në muajin Prill 2017 dhe të vlefshme deri në datën 10 Maj 2017. Në gjendjen aktuale, për paketën më përfaqësuese “i+fiks” në tregun me pakicë me shpejtësi doëload 6 Mbps (plus 200 minuta drejt Albtelecom dhe Eagle Mobile dhe 60 minuta kombëtare/ndërkombëtare) me cmim 999 lek/muaj me TVSH, një operator e merr shërbimin bistream nga Albtelecom me cmimin 828 Leke (me TVSH) ndërsa marzhi i krijuar për të ofruar të njëjtën paketë me pakicë (pa përfitimet e tjera të konsumatorit) nga operatorë të tjerë është vetëm 171 lek, duke mos mbuluar asnjë pjesë të kostove të këtyre operatorëve për shërbimin që i ofrohet pajtimtarit. Ky problem qëndron dhe për paketat e tjera “i+fiks” të Albtelecom dhe ulja e propozuar me 2.1% është e papërfillshme në relacion me tërësinë e ofertave të hedhura në treg nga Albtelecom në muajin Prill 2017. Këto tarifa nuk krijojnë mundësinë për të konkurruar me Albtelecom në tregun me pakicë të aksesit broadband dhe në këto kushte tarifat e aksesit bitstream duhet të reduktohen deri në 50%. Sic është theksuar në footnote më sipër, ankesa të ngjashme me Abissnet kanë dërguar dhe tre operatore të tjerë. Abcom ka dërguar në AKEP një ankim të ngjashëm (marzhi midis cmimeve me shumicë të aksesit bitstream dhe cmimeve me pakicë të ofertës promovionale të Albtelecom në Prill 2017) duke kërkuar nga AKEP që në rregullimin e tarifave të marrë në konsideratë zbatimin e përcaktimeve të ligjit 9918 për parandalimin e sjelljeve antikonkurruese dhe diskriminimit të perdoresve fundorë dhe konkurruesve në treg që mund të rezultojnë nga veprimet e sipërmarresit me fuqi të ndjeshme në treg për tarifën.

- Në lidhje me komentet e Vodafone për orientimin në kosto të tarifave me shumicë të Albtelecom, AKEP sqaron se në dokumentin “Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse - Dokumenti Përfundimtar” miratuar me VKD nr.2703, datë 22.12.2016, në kapitullin 5 është shprehur ndër të tjera se:

*....per perspektiven afat-mesme dhe afat-gjate, AKEP vlereson se alternativa me e mire per rregullimin e tarifave te produkteve dhe shërbimeve me shumice te aksesit ne rrjetet fikse eshte perdorimi i rekomandimeve me te fundit te KE dhe BEREC<sup>3</sup> te cilat rekomandojne nder te tjera orientimin ne kosto te tarifave dhe/ose heqjen e detyrimit te rregullimit ex-ante te ketyre tarifave duke shtuar detyrimet e mos-diskriminimit. Megjithate sic eshte theksuar ne dokumnetin e analizes se tregut, aktualisht ky lloj rregullimi ne Shqiperi paraqet komplikacione te cilat do te rrisnin pasigurine e rregullimit te tarifave te aksesit broadband me shumice, dhe keto alternativa (perfshire mundesine e pergatitjes se nje modeli BULRIC per rrjetin NGN/NGA te Albtelecom) do jene objekt vleresimi ne dy vitet e ardhshme nga AKEP.*

---

<sup>3</sup> COMMISSION RECOMMENDATION of 11 September 2013 on consistent non-discrimination obligations and costing methodologies to promote competition and enhance the broadband investment environment (2013/466/EU)

BEREC: Common Position on Layer 2 Wholesale Access Products (6 October 2016)

Adresa: Rr. “Reshit Çollaku”,  
Tiranë

Tel : + 355 4 2259 571  
Fax : + 355 4 2259 106

[www.akep.al](http://www.akep.al)  
[info@akep.al](mailto:info@akep.al)

- Në lidhje me komentet e Abissnet (si dhe të operatorëve të tjerë, përfshirë Abcom) për ngushtimin e marzhit midis cmimeve me shumicë të aksesit bitstream dhe cmimeve me pakicë për ofertat promovionale të Albtelecom në Prill 2017, nga informacioni i dërguar si dhe nga trajtimi i ofertave promovionale për ‘margin squeeze’ rezulton se:
  - i. Ofertat e Albtelecom janë promovionale deri në 10 Maj 2017, dhe të aplikueshme vetëm për pajtimtarët e rinj dhe jo ata ekzistues. Pra nuk kemi të bëjmë me një tarifë standarde apo skonto të aplikuar te të gjithë përdoruesit e aksesit broadband të Albtelecom. Oferta promovionale janë ofruar dhe më parë nga Albtelecom dhe ofrohen dhe nga operatorët e tjerë dhe në shumë raste kanë elementë të ofrimit nën-kosto për një periudhë të kufizuar kohore për promovimin e shërbimit;
  - ii. AKEP nëpërmjet Vendimeve nr. 2703 dhe 2704, datë 22.12.2016, bazuar në këshillimin publik për dokumentin “*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse – Këshillim Publik*”, i kryer më 7.07.2016-15.09.2016, vendosi për heqjen e formulës retail minus për arsyet e përmendura në dokumentin final të miratuar më 22.12.2016.
  - iii. Nga aplikimi i metodës ‘retail minus’ në vende të tjera si dhe nga dokumenta të BEREK (ERG) rezulton ndër të tjera se:
    - a. ERG (sot BEREK)<sup>4</sup> thekson se që ‘Margin Squeeze’ (MS) të jete një strategji racionale (për operatorin që pretendohet se e aplikon atë) duhet të ekzistojnë disa kushte ekonomike:
      - Sipermarresi që pretendohet se aplikon MS duhet të jete vertikalisht i integruar (ose të kete kontroll në inputin upstream (me shumicë));
      - Sipermarresi duhet të kete FNT në tregun me shumicë;
      - Inputi që i ofrohet konkurrenteve në tregun me pakicë duhet të jete në njëfarë menyre ‘thelbesor apo shume i rendesishem’<sup>5</sup>
      - Sipermarrësi duhet të jetë aktiv në tregun me pakicë, i cili nuk duhet të jetë në konkurrencë efektive.

Kjo nuk do të thote që të kete dominancë në këtë treg, por që është e nevojshme të provohet se ai ka stimul të aplikojë MS pasi mund të realizojë fitime të larta në tregun me pakicë. Gjithashtu praktika duhet të rezultojë në një efekt përjashtues dhe dobësim të mundshëm të konkurrencës, dhe që kjo të realizohet praktika e MS duhet të aplikohet për një kohë të mjaftueshme të gjatë.
    - b. në kushtet kur ka shumë inpute dhe produkte me shumicë/pakicë, si dhe në prani të ofertave/promocioneve, këto të fundit ose nuk i nënshtrohen detyrimit ‘retail minus’ ose kur i nënshtrohen për

<sup>4</sup> Report on the Discussion on the application of margin squeeze tests to bundles (ERG (09) 07-Mars 2009)

<sup>5</sup> If the input is not key as downstream competitors may substitute for alternative input(s), margin squeeze would not be a rational strategy.

plotësimin e detyrimit merret si bazë krahasimi tarifa mesatare e ponderuar: tarifat me pakicë (standarde dhe promocionale) të aplikuar gjatë vitit ponderohen me numrin e pajtimtarëve respektivë që i kanë përdorur këto tarifa dhe kjo tarifë mesatare e ponderuar krahasohet me tarifën respektive me shumicë. Pra krahasimi i bërë nga Abissnet (dhe Nisatel) për ofertën promocionale të Albtelecom (me kohëzgjatje në muajin Prill deri në 10.05.2017) duhet analizuar së bashku me tarifat e tjera me pakicë të Albtelecom për aksesin broadband, standarde dhe oferta promocionale, me paketa të integruara ose jo, etj. Komplexiteti i këtij aplikimi ishte dhe një nga arsyt kryesore pse AKEP gjykoj që të heqë detyrimin për retail minus për Albtelecom në përfundim të kështillimit publik më 22.12.2016, ku duhet vënë në dukje se nga operatorët alternativë nuk kishte asnjë koment.

- iv. Detyrimi për dhënie aksesi bitstream me shumicë dhe problemet e ‘margin squeeze’ janë për rastet kur ofrimi i aksesit broadband në nivel me pakicë nga operatorët e tjerë është i varur në masë të konsiderueshme (essential or key sipas ERG) nga inputet apo aksesi (përfshirë tarifat) në nivel me shumicë që marrin nga operatorit me FNT me të cilin konkurrojnë në tregun me pakicë. Nga të dhënat për aksesin bitstream në Shqipëri rezulton se numri i përdoruesve fundorë që përfitojnë akses broadband nga operatorët të tjerë nëpërmjet aksesit me shumicë bitstream nga Albtelecom është shumë i vogël (rreth 2400) në krahasim jo vetëm me numrin e përdoruesve të Albtelecom të aksesit broadband me pakicë por edhe në raport me numrin e përdoruesve të Abissnet (ndërkohë Nisatel nuk e përdor këtë shërbim me shumicë të Albtelecom për ofrim në tregun me pakicë), pasi shumica e operatorëve përdorin resurset e tyre në vend të inputeve me shumicë nga Albtelecom.
- v. Krahasimi për marzhe individuale midis tarifave për produkte me shumicë/produkte me pakicë është më i arsyeshëm në rastet e rishitjes, ndërkohë që marrëdhëniet e operatorëve me Albtelecom për akses me shumicë bitstream lejojnë për diversifikim në retail të këtyre operatorëve dhe jo thjesht rishitje të produkteve të Albtelecom, pra mundësi më të mëdha konkurrence në retail.
- vi. Pjesa e tregut e Albtelecom në tregun me pakicë të aksesit broadband është në nivelin 40% dhe me prezencë të një numri të madh operatorësh që kanë rrjetet e tyre për lidhje direkte me përdoruesit fundorë dhe që nuk varen nga inputet me shumicë të Albtelecom për të konkurruar në tregun me pakicë. Madje segmentimi gjeografik i tregut me pakicë tregon se Albtelecom në disa zona gjeografike ka pjesë tregu më të ulët se 40% dhe se disa operatorë alternativë me prezencë të fortë lokale kanë pjesë tregu të krahasueshme me Albtelecom. Tregu ka pasur rritje të qëndrueshme në numër pajtimtarësh për shumicën e operatorëve kryesorë në këtë treg dhe në prani të konkurrencës së shtuar nëpërmjet ofertave promocionale prezente të shumica e këtyre operatorëve. Prezenca e infrastrukturave alternative, si rrjetet kablore koaksiale përmendet dhe nga BEREC si një faktor që ndikon në zbutjen e problemeve të mundshme të ‘margin

squeeze' për shkak të zgjedhjes që kanë operatorët alternativë për inputet e nevojshme me shumicë për të ofruar akses broadband në tregun me pakicë. Përveç kësaj ERG/BEREC rekomandojnë që në testet për 'margin squeeze' të merrene në konsideratë jo vetëm mundësitë e zgjedhjes së infrastrukturave alternative por dhe inputet e tjera me shumicë si LLU etj., që mundësojnë ofrimin e aksesit broadband me pakicë nga operatorët alternativë. Në Shqipëri disa prej operatorëve kryesorë të ofrimit të aksesit broadband me pakicë zotërojnë rrjete kabllorë koaksiale (Abcom operatori i dytë më i madh i aksesit broadband me pakicë me 20% pjesë tregu), si dhe rrjete FTTH/B të cilat përbëjnë 11% të të gjitha lidhjeve të aksesit broadband fikse, dhe Abissnet është ofruesi kryesor i këtyre lidhjeve me 25% pjesë tregu në FTTH/B.

7. AKEP pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën dhe argumentet e Albtelecom sh.a të dërguara me shkresat e cituara më sipër si dhe komentet e palëve të interesuara për dokumentin e nxjerrë në këshillim publik, vlerëson të pranojë pjesërisht ankimin e Albtelecom duke kryer rishikim të tarifave të përcaktuara në Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2703 dhe 2704, datë 22.12.2016, sipas propozimit të dokumentit "*Rishikimi i tarifave të aksesit bitstream dhe LLU të miratuara me Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2703 dhe 2704, datë 22.12.2016*", i publikuar në faqen e Internetit të AKEP, dhe bashkangjitur këtij vendimi. Ky rishikimi i shërben realizimit të objektivave rregullatore për nxitjen e konkurrencës në tregun me pakicë të aksesit broadband nga rrjete fikse si dhe promovimit të investimeve në rrjete fikse broadband.

## **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Në mbështetje të procedurës së përcaktuar në nenin 136 të ligjit nr. 44/2015, në përfundim të afatit sipas pikës 2 të nenin 140 të këtij ligji, pasi e gjen të bazuar arsyetimin e qëndrimit të mbajtur nga AKEP në shqyrtim të ankimit administrativ, në dispozitat ligjore të parashikuara në nenet 6, 44, 53,55 e vijues të ligjin nr. 9918 objektivat rregullatore të përcaktuara në nenin 7, të këtij ligji, si dhe legjislacionin e fushës sipas akteve të KE dhe BEREC,

## **V E N D O S:**

1. Të pranojë pjesërisht ankimin administrative të sipërmarresit Albtelecom sh.a për Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr.2703 dhe nr.2704, datë 22.12.2016, duke rishikuar tarifat me shumicë të aksesit broadband, si më poshtë vijon:
  - a. Tarifat e përcaktuara në Tabelën 8 në dokumentin e miratuar me VKD nr.2703, datë 22.12.2016 dhe në Tabelën 1 në pikën 1/a të Vendimit nr.2704, datë 22.12.2016, zëvendësohen me tarifat sipas tabelës së mëposhtëme:



**Tarifat maksimale me shumice te Albtelecom per aksesin LLU**

	<b>Tarifa aktuale</b>	<b>Tarifat 1.07.2017-ne një vendim tjetër të AKEP</b>
<b>Tarifa Mujore:</b>		
Akses i plotë në rrjetin local (LLU)-MSAN	678	664
Akses i përbashket në rrjetin local (LLU)-MSAN	407	398
<b>Pagesa instalimi për LLU:</b>		
Instalimi i aksesit të plotë në rrjetin lokal	1,686	1,686
Instalimi i aksesit të përbashkët në rrjetin lokal të hapur	2,452	2,452

*Shënim: Tarifat në LEK pa TVSH*

- b. Tarifat e përcaktuara në Tabelën 10 në dokumentin e miratuar me VKD nr.2703, datë 22.12.2016 dhe në Tabelën 3 në pikën 2/a të Vendimit nr.2704, datë 22.12.2016, zëvendësohen me tarifat sipas tabelës së mëposhtme

**Tarifat Maksimale me shumice të Albtelecom per aksesin ne tubacione ne nivel Lokal**

	<b>Tarifa aktuale</b>				<b>Tarifat 1.07.2017-ne një vendim tjetër të AKEP</b>			
	<b>Opsioni 1: Bitstream ne Ethernet</b>		<b>Opsioni 2: Bitstream ne IP</b>		<b>Opsioni 1: Bitstream ne Ethernet</b>		<b>Opsioni 2: Bitstream ne IP</b>	
	deri 100 porta	>100 porta	deri 100 porta	>100 porta	deri 100 porta	>100 porta	deri 100 porta	>100 porta
<b>2 Mbps</b>	468	421	549	494	458	412	537	484
<b>4 Mbps</b>	623	560	731	658	610	548	716	644
<b>6 Mbps</b>	766	690	900	810	750	676	881	793
<b>8 Mbps</b>	1,020	920	1,200	1,080	999	901	1,175	1,057
<b>10 Mbps</b>	1,100	990	1,292	1,163	1,077	969	1,265	1,139
<b>12Mbps</b>	1,213	1,090	1,425	1,283	1,188	1,067	1,395	1,256
<b>16 Mbps</b>	1,395	1,260	1,640	1,470	1,366	1,234	1,606	1,439

*Shënim: Tarifat në Lek pa TVSH*

- c. Tarifa minimale prej 334 lek/muaj për aksesin bistream e përcaktuar në fund të seksionit 4.3 në dokumentin e miratuar me VKD nr.2703, datë 22.12.2016 dhe në pikën 2/b të Vendimit nr.2704, datë 22.12.2016, zëvendësohet me tarifën minimale 398 lek/muaj
2. Të njoftohet sipërmarrësi Albtelecom sh.a. dhe palët e tjera të interesuara për zbatimin e këtij Vendimi;

3. Ankimuesi, kundër këtij vendimi mund ti drejtohet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë sipas procedurës dhe afatit të përcaktuar në ligjin nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al)

Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**  
**Piro XHIXHO**

**ANËTARË:**

1. Alban **KARAPICI**
2. Anila **DENAJ**
3. Ketrin **TOPÇIU**
4. Klarina **ALLUSHI**